

# Të drejtat dhe përgjegjësitë e pacienteve dhe pacientëve

Albanisch



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Bundesamt für Gesundheit BAG



Dachverband Schweizerischer  
Patientenstellen

migesplus

# Hyrje

## **Një marrëdhënie e plotë besueshmërie midis pacientes ose pacientit dhe mjekes ose mjekut ka rëndësi thelbësore për një kurim dhe trajtim të suksesshëm.**

Prandaj është e rëndësishme që pacientet dhe pacientët t'i njohin të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Broshura, të cilën ne nga shoqata ombrellë e Qendrës Zvicerane për Pacientë po e publikojmë në kuadër të migesplus bashkë me Kryqin e Kuq Zviceran, do t'ju shërbejë si një udhërrëfyes.

Si paciente ose pacient keni të drejta dhe përgjegjësi, kur bëhet fjalë për kurim dhe trajtim mjekësor.

Të drejtat dhe përgjegjësitë janë rregulluar në një mori ligjesh, rregulloresh dhe dispozitash sendërtuese. Për këtë shkak broshura e

paraqitur mbështetet në ligjet federale si dhe në ato kantonale, së janë Ligji mbi shëndetin, Ligji mbi profesionin mjekësor, Ligji mbi mbrojtjen e të dhënave dhe në mënyrë të veçantë, në Ligjin mbi pacientet dhe pacientët për kantonin e Cyrihut, i hyrë në fuqi më 2007.

Çfarë duhet të mbani mend gjithmonë ju si paciente ose pacient: gjithmonë ekzistojnë terapi dhe metoda të ndryshme trajtimi që shpien drejt cakut. Për këtë shkak, në shumë çështje shëndetësore dhe të sëmundjeve mbetet një hapësirë veprimi për vendime sipas vullnetit të lirë. Pos kësaj, edhe në epokën e përparimeve të mëdha në fushën e mjekësisë, gjithçka që dëshirohet nuk realizohet dot.

Broshura që po ju paraqesim jep përgjigje në pyetjet vijuese:

A e dini se...

- ... si krijohet raporti juridik midis jush dhe mjekes ose mjekut tuaj?
- ... si shfaqet e drejta e vetëvendosjes tek të rriturit dhe të miturit?
- ... krahas përgjegjësisë keni edhe të drejtën e informimit dhe të sqarimit?
- ... një mjek duhet t'i përmbahet në secilin rast sekretit profesional?
- ... kur keni të drejtën e këqyrjes në dokumentacionin tuaj klientist?
- ... keni të drejtën e një trajtimi të kujdesshëm?



# Përmbajtja

1.	Raporti juridik	Faqe 4
1.1	Raporti juridik midis pacientes, pacientit dhe mjekes, mjekut	Faqe 4
1.2	Raporti i trajtimit mjekësor	Faqe 4
2.	E drejta e pacientëve, pacienteve për vetëvendosje	Faqe 5
2.1	Përrjashtime nga e drejta për vetëvendosje	Faqe 6
3.	E drejta e vetëvendosjes për pacientet ose pacientët e mitur, të paaftë dhe pa aftësi gjykimi	Faqe 7
3.1	E drejta për vetëvendosje e të miturve	Faqe 7
4.	Përgjegjësitë e pacienteve dhe pacientëve	Faqe 8
5.	E drejta për informacion dhe sqarim gjithëpërfshirës	Faqe 10
6.	E drejta për ruajtje sekreti	Faqe 11
7.	E drejta për trajtim të kujdesshëm	Faqe 12
8.	E drejta e këqyrjes së kartelës mjekësore personale	Faqe 13
9.	Të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja në spital	Faqe 14



# 1. Raporti juridik

## 1.1 Raporti juridik midis pacientes, pacientit dhe mjekes, mjekut.

*Më e rëndësishmja shkurt:*

- Mjekja ose mjeku është i obliguar që të mjekojë një person në nevojë urgjente në rast sëmundjeje ose fatkeqësie.
- Spitalet publike, siç janë spitalet qytetëse dhe kantonale në gjithë Zvicrën, janë të detyruara t'i mjekojnë pacientet dhe pacientët në raste urgjente.



*Baza juridike:*

Raporti ligjor midis mjekes ose mjekut dhe juve si paciente ose pacient i nështrohet të drejtës së detyrës (mandatimit). Dmth., ju pajtoni në punë mjeken ose mjekun përmes trajtimit tuaj mjekësor. Kontrata rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë dhe me aprovimin e trajtimit ajo fiton plotfuqishmëri ligjore.

*Shënim:*

- Ju mund të zgjidhni ose të zëvendësoni sipas dëshirës suaj mjeken ose mjekun po qe se nuk keni nënshkruar tashmë ndonjë sigurim të veçantë si HMO ose modelin e mjekut familjar.
- Ju nuk keni të drejtën e pranimit, po qe se doni të trajtoheni në spital pa një nevojë urgjente.

- Nëse ju ose përfaqësuesi juaj ligjor (psh. tutori) refuzoni një trajtim mjekësor rreth përparësive dhe mangësive të të cilit tashmë jeni sqaruar, sipas rregullit, një gjë të tillë duhet ta vërtetoni me nënshkrimin tuaj. Refuzimi i nënshkrimit do të dokumentohet.
- Mjekja ose mjeku i juaj mund ta refuzojnë ose ndërpresin një trajtim po qe se me këtë gjë nuk do t'ju shkaktohet ndonjë dëm.
- Mjekja ose mjeku vendosin nëse trajtimi duhet bërë në spital.
  - Sipas sigurimit bazë, trajtimet spitalore janë të siguruar vetëm në kantonin ku banoni.
  - Po qe se një trajtim i caktuar është i përealizueshëm dot në kantonin e banimit, trajtimi në një kanton tjetër do të bartet nga sigurimi shëndetësor.

## 1.2 Raporti i trajtimit mjekësor

Një raport i mirë dhe me besueshmëri të plotë midis pacientes ose pacientit dhe mjekes ose mjekut është fundamental për një trajtim ose përkujdesje. Për këtë shkak ka rëndësi të madhe zgjedhja e mjekes ose e mjekut.

Mjeken ose mjekun tuaj familjar kërkojeni në ditët kur jeni shëndoshë. Informohuni në familjen tuaj, në rrethin tuaj miqësor dhe në mjedisin tuaj; kështu do të gjeni mjeken ose mjekun familjar që ju përshtatet. Merrni shënim se cilat janë përfytyrimet tuaja për mjekun tuaj ose për ordinancën e tij.

## Ç'përfytyrime kam për mjeken ose mjekun tim familjar?

### Listë kontrolli:

- Parapëlqeni një mjekje apo një mjek?
  - Ç'moshë duhet te ketë ajo ose ai për afërsisht?
  - A e kupton ajo ose ai gjuhën tuaj?
  - A duhet të llogarisni, sipas rregullit, me kohë pritjeje?
  - Si e ndjeni veten në kontakt me të?
  - A ju ofron ajo ose ai vizita në shtëpi?
  - A ka orë konsultash të lira?
  - A do të të mund të trajtojë gjithë anëtarët e familjes?
  - A bëjnë pjesë shërbimet mjekësore komplementare (homeopatia, akupunktura etj.) në metodat e tij kuruese? Ose, a është mjeku i juaj së paku i hapur kundrejt këtyre metodave?
- A ka mjeku ose mjekja juaj ndonjë titull profesional?
  - A ka ai ose ajo aftësi të tjera të njohura prej ndonjë shoqate profesionale?
  - A duhet që ordianca të jetë në afërsi të vendit tuaj të banimit ose të punës?
  - A është e arritshme ajo (ordianca) me mjete të trafikut publik?
  - A ka vende parkimi?
  - A mund të hyhet në ordiancë edhe me karrocë invalidësh?



## 2. E drejta e pacientëve, pacienteve për vetëvendosje


### Më e rëndësishmja shkurt:

- Nëse jeni i aftë për gjykim e veprim, ju keni të drejtën që të mos ju trajtojnë kundër vullnetit tuaj.
- Ju keni të drejtën ta refuzoni një trajtim mjekësor, edhe po të jetë ai urgjentisht i domosdoshëm nga pikëpamja mjekësore.

### Baza juridike:

Vaksinimet, testet e HIV-it ose ato gjenetike nuk guxojnë të zbatohen pa pëlqimin tuaj. Dakordimi për trajtim mund të bëhet me gojë ose me shkrim, ndërkaq, në ndërhyrjet me vetëdashje ose tek ato me rrezikshmëri të lartë, ai gjithmonë bëhet me shkrim.

- Ju keni të drejtën të përfshini një opinion të dytë nga një mjek ose mjekje. Kjo mund të jetë e dobishme atëherë kur për po atë sëmundje ekzistojnë trajtime të ndryshme ose kur duhet të vendosni pro ose kundër një trajtimi.




- Ju keni të drejtën të refuzoni kontrollet profilaktike. Përpara një kontrolli profilaktik shoshitni mirë në secilin rast dobinë, riskun dhe konsekuencat. Vendimin do t'ju lehtësonte fakti nëse do të përfytyronit se si do të sillleshit në rast të një rezultati të pavolitshëm.
- Ju keni të drejtën të plotësoni një fletë-udhëzimi. Me një akt të tillë ju mund t'i përbaheni vullnetit tuaj në rast se nuk do të jeni në gjendje të flisni për veten. Fletë-udhëzimi duhet të jetë i bazuar në vetëdashjen tuaj, ju duhet ta përpiloni atë në gjendje aftësie gjyqimi dhe duhet ta ripërtëritni (vërtetoni) atë rregullisht me nënshkrime plotësuese. Fletë-udhëzimi, në rast të ndonjë ndodhie, s' mund të jetë më i vjetër se dy vite.

## 2.1 Përrjashtime nga e drejta për vetëvendosje

- Në interes të komunitetit, në rast sëmundjesh të transmetueshme, pacientet dhe pacientët mund të izoloohen dhe mund të detyrohen për mjekim (psh. në rastin e tuberkolozit, tifos, meningjtit etj.)
- Mjekja ose mjeku vendosin lidhur me paaftësinë vendimmarrëse në një rast urgjent, sipas dëshirës së supozuar të pacientit ose pacientes. Mjekja ose mjeku është i detyruar t'i ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për të mbajtur gjallë ose për të shpëtuar jetën.
- Kirurgu ose kirurgia mund ta zgjerojnë ndërhyrjen e tyre gjatë

një operacioni po qe se kjo gjë është urgjentisht e domosdoshme (shpëtimtare për jetën) dhe po qe se në bisedën sqaruuese aprovimi i personit referent mund të merret si i besueshëm.

- Mjekja ose mjeku në secilin rast, sa më parë që të jetë e mundur, duhet ta informojnë pacientin lidhur me zgjerimin e trajtimit ose mbi trajtimin emergjent.
- Nëse një sqarim paraprijës nuk është i mundur, ai duhet siguruar më pas, sa më parë që të jetë e mundur.



## 3. E drejta e vetëvendosjes për pacientet ose pacientët e mitur, të paaftë dhe pa aftësi gjykimi

*Më e rëndësishmja shkurt:*

- Në rast rrezikimi akut nga vetja ose nga të tjerët mund të zbatohet një heqje profilaktike lirie (HPL) kundër vullnetit të personit të prekur.
- Një HPL (në origjinal: FFE = fürsorgerischer Freiheitsentzug) duhet të jetë gjithnjë në përmasën adekuate: po qe se një ndërhyrje e lehtë, qoftë dhe një trajtim ambulator, mund t'i sigurojë personit të prekur mbrojtje të njëjlojtë, ajo (HPL) nuk duhet zbatuar.
- Një HPL duhet zbatuar vetëm si rrugëzgjdhjen e fundit.
- Personat e prekur kanë mundësinë për apelim. Secila paciente ose secili pacient, ose personat e tyre më të afërt, mund të kërkojnë brenda 10 ditësh përmes një letre joformale lëshimin e një vendimi gjyqësor kundër një udhëzimi, një refuzimi të kërkesës për lëshim (lirim), kundër mbajtjes peng (për garanci pagese) ose kundër rikthimit në gjendjen e mëparshme.
- Në rast vendimesh të rëndësishme duhet marrë parasysh dhe respektuar edhe dëshira e supozuar e patientes ose pacientit të mitur.
- Në rastin e patienteve dhe patientëve pa aftësi gjykimi, të drejtat e tyre duhet t'i përfaqësojë pjesëtari i afërt i familjes ose përfaqësuesi ligjor.
- Në rastin e patienteve dhe patientëve të mitur ose të paaftë, lidhur me format e mundshme të kurimit duhet informuar dhe sqaruar, nëse ka nevojë, edhe përfaqësuesi ligjor.
- Në rastin e patienteve dhe patientëve me paaftësi gjykimi pa përfaqësim ligjor kjo e drejtë për sqarim u takon edhe personave referentë.

### **Këshillë:**

Në rast të një HPL, sipas rastit, rekomandohet që të involvohet një person i jashtëm nga rrethi i fafesisit, i të njohurve ose nga kisha, mjekja ose mjeku familjar dhe/ose një avokat.

### 3.1 E drejta për vetëvendosje e të miturve:

Të miturit e moshës prej afro 14 ose 15 vjet, sipas rastit, konsiderohen si me aftësi arsyetimi. Atyre u takojnë po ato të drejta si edhe të rriturve. Në rastin e të miturve më të vegjël vendosin prindërit, përkatësisht, përfaqësuesi ligjor.



### *Përrjashtim:*

Po qe se prindërit e një fëmije nuk e aprovojnë një trajtim mjekësor urgjentisht të domosdoshëm për shkaqe religjioze ose bindje të tjera personale, mjekja ose mjeku ka të drejtën të përfshijë autoritetin kujdestar (tutelën) dhe të iniciojë një procedurë që do të mund t'ua mohonte prindërve ushtrimin e autoritetit prindor.



## 4. Përgjegjësitë e pacienteve dhe pacientëve:


*Më e rëndësishmja shkurt:*

- Përgjegjësia e bashkëveprimit
- Detyrimi i bashkëpërgjegjësisë
- Detyrimi i zvogëlimit të dëmit

*Baza juridike:*

Ju obligoheni që pyetjeve të mjekut ose mjekes tu përgjigjeni çiltërsisht (besnikërisht). I jepni të gjitha të dhënat lidhur me gjendjen tuaj shëndetësore dhe emëroni, po të jetë e mundur, shkaku e sëmundjes.

Nëse, psh., nuk dëshironi t'i merrni barërat, flisni për këtë gjë me mjeken ose me mjekun.



Kundrejt sigurimit tuaj shëndetësor keni detyrim për zvogëlim dëmtimi. Kjo do të thotë që jeni i/e obliguar të ndërmerrni gjithçka brenda arsyes me qëllim që dëmi të zvogëlohet ose që të mos paraqitet.

**Përshkrimi i saktë i simptomave tuaja si dhe dëgjimi i kujdesshëm i mjekes, mjekut, ndihmojnë që...**

- ... të kuptohet problemi juaj
- ... të dalin në dritë shkaqet
- ... të identifikohen sëmundjet
- ... të gjendet terapia e duhur

**Biseda me mjeken ose me mjekun:**

- Përgatituni për bisedën me mjeken, me mjekun tuaj: para bisedës merrni shënim të gjitha pyetjet tuaja.
- Merrni me vete një person të besueshëm, po që se gjendeni përpara një vendimi të vështirë (psh. në rastin e një sëmundjeje kanceroze) ose kur duhet të informoheni për ndonjë diagnozë të re – dy persona dëgjojnë më shumë dhe më ndryshe se sa personi i prekur drejtpërdrejt.
- Pyesni paraprakisht për ndonjë përkthyes ose përkthyes, po që se ndjeheni i/e pasigurtë për sa i përket gjuhës.

Çdo trajtim mjekësor duhet biseduar, qoftë fjala për një kontroll, një operacion, një hemoterapi apo një rrezatim:

- Cilat para- ose paskontrollime janë të domosdoshme?
- A ka ndonjë alternativë për ndërhyrjen e propozuar?
- Cilat janë risqet dhe pasojat e mundshme?
- Cilat post-trajtime janë të domosdoshme?
- Ç'është rezultat mund të pritët nga operacioni?
- Sa gjatë, përafërsisht, mund të zgjasë shërimi dhe si zhvillohet ai?
- A ekzistojnë mundësi të ndryshme anesteziologjike?





### **Pyesni derisa të keni kuptuar gjithçka:**

Lejoni t'ju operojnë vetëm kur të keni besim kundrejt kirurges ose kirurgut pas bisedës me ta dhe po qe se mund ta merrni vetë vendimin për ndërhyrje. Mund të jetë me vend që të kërkonj një opinion të dytë. Nëse ju është e njohur ndonjë metodë tjetër operative, e zini në gojë këtë gjë. Nëse nuk mund të vendosni për metodën e propozuar, mund të ndërroni mjeken

ose mjekun. Vendosni për procesin e mëtejshëm vetëm kur të jeni siguruar se keni kuptuar gjithçka.

Rezervoni kohë për të vendosur. Përpos në rast urgjence, asnjë trajtim ose terapi nuk është me aq ngut sa të mos merrni së paku një natë kohë për të pleqëruar (shoshitur).

## 5. E drejta për informacion dhe sqarim gjithëpërfshirës

Si paciente ose pacient ju mund të vendosni vetë pro ose kundër një trajtimi, po qe se jeni informuar mirë dhe gjerësisht. Mjeket dhe mjekët janë të obliguar t'ju dorëzojnë dokumentacionin e duhur që ju të mund të vendosni. Edhe sikur të keni besim absolut tek mjekja ose mjeku i juaj, dhet t'i njihni dobitë dhe risqet e një trajtimi.



### *Më e rëndësishmja shkurt:*

- Një trajtim mjekësor mund të fillojë kur të jeni sqaruar gjerësisht dhe kur të keni dhënë dakordimin.
- Mjekja ose mjeku i juaj është i obliguar që në formë të përshtatshme, në gjuhë konkrete dhe të kuptueshme, t'ju sqarojë lidhur me gjendjen tuaj shëndetësore.
- Mjekja ose mjeku i juaj duhet t'ju komunikojnë se me çfarë mund t'i kontribuoni ju vetë shërimit.
- Mjekja ose mjeku i juaj duhet t'ju informojnë lidhur me mundësitë e ndryshme të kurimit, alternativat dhe shanset e shërimit, risqet dhe efektet anësore.
- Paraparakisht ju duhet të keni një pasqyrë të shpenzimeve eventuale.

### *Baza vendimmarrëse:*

Vetëm pasi të keni dhënë aprovimin, pas sqarimeve gjithëpërfshirëse, mund të fillojë trajtimi. Aprovimin mund ta bëni me gojë ose përmes një protokollit sqarues të nënshkruar. Përmes nënshkrimit ju vërtetoni se jeni dakord me trajtimin ose ndërhyrjen dhe se jeni sqaruar lidhur me risqet.

Ju nuk jeni i/e obliguar ta nënshkruani menjëherë protokollin sqarues, por mund ta bisedoni atë, të pyesni lidhur me të ose ta pleqëroni në qetësi. Nëse keni vështirësi gjuhësore, ia transmetoni këtë gjë mjekut dhe pyesni për një përkthim. Ju mund të shtroni pyetje edhe më pas. Protokollit sqarues nuk e zëvendëson dot informacionin gojor.

### *Shënime plotësuese:*

- Si paciente ose pacient keni të drejtën e mosdijes! Heqjen dorë nga sqarimi duhet ta fiksoni me shkrim, shprehimisht dhe pa mundësi keqkuptimi. Për shembull: kur në rastin e një diagnoze me kancer nuk doni të keni dijeni për prognozën e kohës që ju ka mbetur për ta jetuar.
- Një sqarim mund të shmangët (heshtet) po qe se ekziston arsyeja e supozimit se ai mund t'ju shkaktojë dëm. Për shembull: kur ekzistojnë akoma dyshime të bazuara lidhur me diagnozën. Mirëpo ai megjithatë mund të bëhet nëse kërkohet shprehimisht prej jush.
- Përgjithësisht nuk ekziston vetëm një lloj i vetëm trajtimi ose një çast i vetëm i duhur ndërhyrjeje. Gjithmonë ka përparësi dhe disavantazhe. Prandaj ka rëndësi që midis disa trajtimit të gjeni zgjidhjen më të mirë dhe më

të efektshme për gjendjen tuaj. E njëjta gjë vlen dhe për çastin e duhur të ndërhyrjes.

### **Këshillë:**

Është me rëndësi që gjatë bisedës me personelin profesional mjekësor të dëgjoni me saktësi dhe të pyesni deri atëherë kur të keni kuptuar gjithçka me saktësi. Mund t'ju ndihmojë, gjithashtu, nëse pyetjet tuaja t'i keni fiksuar paraprakisht me shkrim. Vendosi për procedimet e mëtejshme vetëm pas një sqarimi gjithëpërfshirës.

## **6. E drejta për ruajtje sekreti**

*Më e rëndësishmja shkurt:*

- Mjeket, mjekët dhe personeli profesional mjekësor i nënshtrohen sekretit profesional. Ata i nënshtrohen detyrimit absolut për heshtje. Kjo do të thotë që ata nuk guxojnë t'ua transmetojnë personave të tretë (familjarëve, punëdhënësit, sigurimeve etj.) faktet mbi pacientin ose pacienten pa aprovimin përkatës.
- Të dhënat e evidentuara duhen mbrojtur prej këqyrjes dhe përpunimit të paautorizuar.



- Ju mund ta lironi nga detyrimi i heshtjes mjeken, mjekun ose personelin mjekësor profesional përmes një autorizimi personal.

*Përjashtime nga detyrimi mjekësor për heshtje:*

- Në rastin e sëmundjeve të caktuara të transmetueshme, si tuberkulozi, ekziston detyrimi i njoftimit tek shërbimi kompetent mjekësor kantonal, i cili, nga ana e tij, i nënshtrohet sekretit zyrtar.
- Në rastin e një vdekjeje të pazakonshme, të dëmtimeve trupore që mund të lidhen me ndonjë krim, dhe në rast dyshimi për ndonjë delikt ordinar (keqtrajtimi i të miturve, abuzimi seksual, dëmtime të rënda trupore, vrasja) mjeket dhe mjekët janë të detyruar të vënë në dijeni organet e ndjekjes penale.
- Për të drejtën e këqyrjes së akteve pas vdekjes, familjarët duhet të paraqesin kërkesën e tyre të arsyetuar tek drejtorja shëndetësore e kantonit përkatës për heqjen e sekretit profesional.

*Baza juridike:*

Sekreti profesional vlen edhe kundrejt të gjitha mjekëve, mjekëve ose personelit mjekësor profesional të reparteve tjera, që nuk janë pjesëmarrës direkt në trajtim dhe që për këtë shkak nuk kanë ndonjë interes profesional.

Mirëpo mjeket ose mjekët e trajtimeve fillestare dhe të mëpasme (pas ndërhyrjes) si edhe persona të tjerë vazhdues të mjekimit, mund të orientohen me kohë për gjendjen shëndetësore dhe për masat tjera të nevojshme, po qe se ju si paciente ose pacient nuk jeni kundër.

Të dhëna të caktuara mjekësore mund të përdoren për qëllime hulumtuese shkencore, po qe se personi referent e lejon shprehimisht këtë gjë dhe që të dhënat do të përcillen në anonimitet. Përkundrazi, mësimdhënia klinike

dhe vizitat përmes personelit profesional, gjithë përderisa të jenë në interes të mjekimit, janë të lejuara.

#### *Në praktikë:*

Personeli mjekësor profesional nuk do t'ia refuzojë informacionin familjarit më të afërm, po qe se konsideron se pacientja ose pacienti do ta jepte aprovimin, mirëpo nuk është në gjendje ta bëjë vetë këtë gjë.

## 7. E drejta për trajtim të kujdesshëm

### *Më e rëndësishmja shkurt:*

- Ju keni të drejtën e përkujdesjes më të mirë të mundshme dhe trajtim të kujdesshëm.
- Po qe se s'ka shpresa shërimi, prej një terapie mund të kërkoni zbutjen e dhimbjeve e vuajtjeve si dhe përmirësimin e cilësisë jetësore.
- Trajtimet udhëhiqen në bazë të parimeve të humanitetit, me këtë rast duhet respektuar sidomos dinjiteti njerëzor.
- Kontrollat dhe trajtimet udhëhiqen sipas rregullave të pranura të mjekësisë dhe sipas gjendjes aktuale të shkencës mjekësore. Mund të predispozohet arsimimi i domosdoshëm i mëtejshëm i rregullt në fushën përkatëse profesionale dhe informacioni përmes literaturës profesionale. Nëpër ordinancat mjekësore diplomat mund të shihen.
- Aparaturat teknike, si ultrazëri, duhet të mirëmbahen dhe duhet siguruar një shërbim i kualifikuar profesional.

### *Baza juridike:*

Mjeku ose mjekja mban detyrimin e gjithanshëm për kujdes në të gjitha fushat e trajtimit mjekësor.

Jo çfarëdo komplikacioni ose rreziku i një trajtimi përbën një shkelje të obligimit mjekësor për përkujdesje. Kjo vlen edhe për rastin e një zhvillimi ters të një sëmundjeje. Secili rast është individual. Nëse keni përshtypjen se jeni prekur nga një shkelje e detyrimit mjekësor për përkujdesje, rekomandohet një këshillim në kohën e duhur prej ndonjë qendre profesionale. Nëse kërkoni llogaridhënie për ndonjë dëmtim, duhen marrë parasysh urgjentisht afatet e ndryshme të parashkrimit dhe të aprovimit të heshtur.

### *Vërejtje:*

Medikamentet e reja dhe procedurat e reja kuruese nuk janë domosdoshmërisht më të mira ose më të përshtatshme se sa ato ekzistueset. Jini kritik ndaj premtimeve nga reklamata. Një metodë



e sprovuar e kurimit mund të zëvendësohet vetëm atëherë kur e reja është dëshmuar si dukshëm më efektive ose është e lidhur me më pak efekte anësore. Mirëpo një zëvendësim të mundshëm të barërave ju duhet ta bisedoni në çdo rast me mjeken, mjekun, farmacisten ose farmacistin.

*Parim:*

Mjekja ose mjeku nuk mund t'i zgjidhin të gjitha problemet dhe jo të gjitha sëmundjet janë të shërueshme. Nuk ekziston e drejta për shërim!

## 8. E drejta e këqyrjes së kartelës mjekësore personale

*Më e rëndësishmja shkurt:*

- Mjekja ose mjeku është i obliguar t'i dokumentojë pandërprerë detyrat në vijim:
  - gjendjen shëndetësore
  - simptomat e përshkruara
  - diagnozën e dyshuar
  - trajtimet e porositura
  - rezultatet e trajtimeve, të kontrolleve të reja, ndërhyrjeve, analizave laboratorike, incizimeve radiografike etj.
  - të dhënat kohore për fillimin dhe mbarimin e trajtimit
  - datën e konsultimeve
  - transferimet


- Ju keni të drejtën për këqyrjen e kartelës klinike të pacientit dhe të bëni edhe kopje të saj
- Në kartelën e pacientit bëjnë pjesë, krahas raporteve mbi rrjedhën e mjekimit dhe të daljes, edhe protokollet sqaruese, raportet operacionale, protokollet anesteziologjike, sipas rregullit, edhe shënime në dorëshkrim, qoftë edhe sikur të jenë shënuar supozimet e mjekes apo mjekut.

*Baza juridike:*

Dokumentacioni i pacientit mund të administrohet në formë të shkruar ose elektronike. Ai duhet arkivuar së paku edhe 10 vjet pas trajtimit të fundit. Vërtetësia e të dhënave dhe dokumentave duhet të jetë gjithmonë e garantuar. Mjekja ose mjeku janë të detyruara që personit të trajtuar t'ia sigurojnë të drejtën e këqyrjes së akteve dhe që dosjen e pacientit t'ia ekspozojnë si dhe të japin llogari përpara tij si punëdhënës. Ai mund të kërkojë dhe korrigjimin e dokumentave.

*E rëndësishme:*

Ju keni të drejtën mbi dosjen tuaj të pacientit.



## 9. Të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja në spital

*Më e rëndësishmja shkurt:*

- Ju dhe familjarët tuaj, në rast nevoje edhe përfaqësuesi i juaj, duhet të informoheni në gjuhë të kuptueshme për rrjedhën ditore të institucionit mjekues dhe përkujdesës.
- Duhet t' u bëhen të njohur emrat dhe funksioni i personave përkujdesës.



- Duhet t' i përmbaheni rendit shtëpiak dhe të keni konsideratë ndaj bashkëpacienteve e bashkëpacientëve.

*Baza juridike:*

Bisedat me mjeken ose mjekun si dhe me personelin përkujdesës mjekues mund të kërkonit që të bëhen jashtë distancës dëgjimore të personave të tretë. Sipas dëshirës, mund të bëni biseda konfidenciale me familjarë ose të njohur si dhe me mjeket dhe mjekët tuaj familjarë. Përpos kësaj, mund të kërkonit që mundësitë për vizita të kufizohen.

Ju keni të drejtë për përkujdesje të përshpirtshme (religjioze).



### **Qendrat ankimore / Këshillimoret për paciente dhe pacientë:**

Dachverband Schweizerische  
Patientenstellen, Hofwiesenstrasse 3,  
8042 Zürich, Tel.-Nr. 044 361 92 56

Patientenstelle ZH, Hofwiesenstrasse 3,  
8042 Zürich

Patientenstelle AG/SO, Bachstrasse 15,  
Postfach 3534, 5001 Aarau

Patientenstelle Basel, Hebelstrasse 53,  
Postfach, 4002 Basel

Patientenstelle Ostschweiz, Zürcher-  
strasse 194a, 8510 Frauenfeld

Patientenstelle Westschweiz, rte de la  
Fonderie 2, 1700 Fribourg

Patientenstelle Zentralschweiz, St. Karli-  
Quai 12, Postfach, 6000 Luzern 5

Patientenstelle Tessin, Via Visconti 1,  
casella postale 1077, 6500 Bellinzona

## Impressum:

Redaktion: Dachverband Schweizerischer  
Patientenstellen (DVSP)  
Auflage: 5'000 Exemplare  
Gestaltung: W. & M. Pfenninger Illustration/  
Grafik/Werbung Zürich  
ALSCHER TEXT & DESIGN, Interlaken  
Druck: Ropress Druckerei, Zürich  
Erscheinungsjahr: 2008  
Copyright DVSP 2008

Mbështetja profesionale dhe financiare:

**migesplus**

Die Broschüren sind mit finanzieller und fachlicher Unterstützung durch migesplus im Rahmen der Bundesstrategie „Migration und Gesundheit 2008 - 2013“ entstanden.

migesplus  
Schweizerisches Rotes Kreuz  
Departement Gesundheit und Integration  
Gesundheitsförderung  
Werkstrasse 18  
CH-3084 Wabern

Diese Broschüre ist in den folgenden Sprachen erhältlich:

Albanisch, Portugiesisch, Serbisch/Kroatisch/  
Bosnisch, Spanisch, Türkisch

Bestellungen:  
Dachverband Schweizerischer Patientenstellen  
(DVSP)  
Hofwiesenstrasse 3  
Postfach  
8042 Zürich  
Tel.: 044 361 92 56  
Email: [info@patientenstelle.ch](mailto:info@patientenstelle.ch)



Broshura që po ju paraqesim jep përgjigje në pyetjet vijuese:

A e dini se...

- ... si krijohet raporti juridik midis jush dhe mjekes ose mjekut tuaj?
- ... si shfaqet e drejta e vetëvendosjes tek të rriturit dhe të miturit?
- ... krahas përgjegjësiave keni edhe të drejtën e informimit dhe të sqarimit?
- ... një mjek duhet t'i përmbahet në secilin rast sekretit profesional?
- ... kur keni te drejtën e këqyrjes në dokumentacionin tuaj klientist?
- ... keni të drejtën e një trajtimi të kujdesshëm?



Diese Broschüre ist in den folgenden Sprachen erhältlich:  
Albanisch, Portugiesisch, Serbisch/Kroatisch/Bosnisch, Spanisch, Türkisch